

FJALA E DEPUTETIT SAIMIR HASALLA

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Të nderuar qytetarë,

Kjo është fjala ime e parë në foltoren e parlamentit, në këtë tempull të demokracisë shqiptare. Ndihem i privilegjuar dhe me përgjegjësi të madhe të përfaqësoj qarkun e Elbasanit, të cilët gjej rastin t'i falënderoj nga zemra për mbështetjen e madhe që më dhanë mua dhe Partisë Socialiste. Janë plot 90 mijë votues që besuan në programin e Partisë Socialiste, të cilëve u premtoj se do të jem zëri i tyre i fuqishëm në Kuvend. Bashkë me deputetët e tjerë të Partisë Socialiste të këtij qarku do të bëjmë përpjekjet maksimale për të vazhduar me investime, për të zgjidhur problemet e tyre dhe për të realizuar projektet madhore të qeverisë në këtë zonë. E lexova me vëmendje buxhetin për vitin 2022 dhe ndaj mendimin, si shumica prej jush, se është buxheti më i duhur dhe më i drejtë i hartuar në frymën për ta bërë Shqipërinë të jetë e ardhmja jone. Buxheti i vitit 2022 është buxheti më i madh dhe më i rëndësishmi në historinë e shtetit Shqiptar. Ky buxhet financon programin e qeverisë dhe drejton rimëkëmbjen e vendit; garanton dhe ka në fokus mbështetjen e rritjes ekonomike të vendit, duke lënë pas krizën dhe duke shtuar mbështetjen sociale dhe shtimin e ndihmës së shtresave më vulnerabël në këtë periudhë të vështirë; mbështet politikën zhvillimore afatmesme të vendit dhe investimet publike për të siguruar një rritje ekonomike afatmesme të stabilizuar dhe shtim të konsoliduar të mirëqenies së qytetarëve.

Tri prioritetet kryesore të buxhetit të vitit 2022 janë: shërbimi ndaj qytetarëve dhe sipërmarrjeve, digjitalizimi, si dhe investimet kyçe në infrastrukture. Do të rriten pagat e punonjësve në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes; do të ngrihet paga minimale, nga 30 në 40 mijë lekë, pavarësisht se ku punojnë; do të zhvendoset kufiri i taksimit dhe do të ulet taksimi për të gjithë të punësuarit; do të mbështetet sektori i bujqësisë (si një sektor mjaft i rëndësishëm për peshën që zë në prodhimin dhe punësimin në ekonomi) nëpërmjet skemave shpesh për fermerët, rimbursimit të naftës, projektit të garancisë së kredisë për zonat rurale dhe garancisë sovrane për fermerët; do të rritet fondi i mbështetjes për shtresat në nevojë; do të rritet ndihma ekonomike, do të trefishohet ndihma për gratë e trafikuar dhe fëmijët e mitur, do të dyfishohet ndihma për nënat me shumë fëmijë dhe parashikohet indeksimi i pensioneve dhe bonusi i fundvitit për pensionistet. Në zbatimin e programit të decentralizimit për shpenzimet e buxhetit vendor synohet një skemë financimi e përshtatshme dhe efektive, që përmirëson në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e shërbimeve. Bashkitë e vogla e kanë shumë të vështirë të investojnë me fondet e tyre në vepra të mëdha, pasi tërmeti dhe pandemia kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e realizimit të të ardhurave të tyre, por edhe bartja e borxheve ndër vite ka ndikuar në këtë aspekt, ndaj kërkoj nga qeveria të shtohet vëmendja e ndihmës ndaj këtyre bashkive, veçanërisht në transfertën e pakushtëzuar, si dhe në transfertën specifike në arsim, mbrojtjen nga zjarri, emergjencat civile, mirëmbajtjen e rrugëve dhe pastrimin.

Do të ndalesha në Bashkinë e Peqinit. Gjatë viteve që kam drejtuar Bashkinë e Peqinit dhe në vitet e fundit është investuar në shumë fusha, si: në infrastrukturë, ujësjellës, arsim, shëndetësi, kanale vaditëse dhe bujqësi. Konkretisht është investuar në rrugën hyrje–dalje dhe unazën e qytetit, në rrugën “Ymer Behluli”, në rrugën “Ali Çeka”, në rrugën e fshatit Trash, në rrugën “Kodra e Ullirit”, në rrugën “Sulejman Bej Pasha”, në rehabilitimin e disa shesheve kryesore në qytetin e Peqinit; në ujësjellësin e fshatit Karinë; në shkollën 9- vjeçare “Gjocaj”, në shkollën 9-vjeçare “Demir Godelli”, në shkollën e mesme “Mustafa Kemal Atatürk” në Pajovë; në ndërtimin dhe rehabilitimin e disa qendrave shëndetësore në Pajovë, Shezë, Gjocaj dhe Karinë; në rehabilitimin dhe ndërtimin e disa kanaleve vaditëse dhe kulluese në shumë fshatra të zonës së Peqinit; në ndërtimin dhe sistemimin e grabionit dhe mbrojtjes lumore në Karinë; në ndërtimin e urës në fshatin Fatishë dhe në ura të tjera më të vogla në fshatra të tjerë të zonës.

Në buxhetin e vitit 2022 është parashikuar vazhdimi i mbështetjes me fonde për investimet e nisura gjatë vitit 2021 në Bashkinë e Peqinit, konkretisht në rrjetin e ujësjellësit të ri për fshatrat Hasmashaj, Gjocaj, Çelhake; në rrjetin e ujësjellësit të ri për fshatin Bishqem; në rrjetin e ujësjellësit të ri për fshatrat Bicaj, Çaushaj; rehabilitimin dhe ndërtimin e stacionit të depove në Peqin; në rehabilitimin dhe ndërtimin e stacionit të pompave në Peqin; në ndërtimin e ri për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza për lagjen Gjenjë në Peqin. Unë e nxis qeverinë të vazhdohet me investime për Bashkinë e Peqinit. Kemi bërë për Bashkinë e Peqinit sa kemi mundur, por jo sa kemi dashur dhe sa meriton ky qytet. Doja të ndalesha te historia e këtij qyteti. Peqini është ndër qytetet më të vjetra në qark e më gjerë, me resurse dhe histori mjaft të pasur. Klaudiana e vjetër meriton vëmendje më të shtuar nga qeveria. Investimi për rilindjen urbane është i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm për rivitalizimin e qendrës historike, aty ku bashkohej rruga “Egnatia”, që nisej nga Apollonia dhe Dyrrahu, ku me mijëra udhëtarë kanë bujtur dhe janë mirëpritur. Kjo zonë meriton të shndërrohet në vlerat që i takojnë. Ia kemi premtuar dhe ia kemi borxh Peqinit, unë personalisht dhe Partia Socialiste. Gjithashtu, do të adresoj kërkesat e banorëve të Peqinit për më shumë investime në rrugë, si në rrugët kryesore, që lidhin Bashkinë e Peqinit me Bashkinë e Tiranës; në rrugët e fshatrave Bishqem, Vashaj, Përparim, Karinë, Algjinaj, Pajovë dhe Shezë; investime në shkollat e Shezës dhe “Adem Bedalli”; investime në qendrën shëndetësore të Peqinit dhe në kanalën vaditëse në Gjocaj.

Jam i bindur dhe besimplotë se së bashku me qeverinë do t’i bëjmë të mundura këto investime. I uroj qeverisë punë të mbarë dhe suksese të merituar në vazhdimin e reformave të ndërmarra! Nuk kemi kohë për pushim. Falë këtyre reformave, sidomos reformave të guximshme në drejtësi, Shqipëria sot është një vend më i mirë se dje, një vend më i sigurt për të jetuar si dhe shumë më pranë Bashkimit Europian. Jemi të vetëdijshëm që kemi ende punë për të bërë, për të ecur përpara me vazhdimin e reformave, për të ç’rrenjosur një herë e mirë korrupsionin, kriminalitetin dhe për të përmirësuar imazhin e vendit në rajon dhe në botë. Faleminderit!